

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Ishte masë ekstreme", Rama flet nga Rinasi për arrestimin e Vlora Hysenit: Çdo dyshim duhet të hetohet deri në fund
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/rama-flet-nga-rinasi-per-vlora-hysenin-do-dyshim-duhet-te-hetohet-der-i402132
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 12:41:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 12:37:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	280f16fa874c9dbe79c8bcaf45e09f5eb44dd888ca0518b2278e7378a1f0eae9
TEKSTI	e5c9bda8e1edf6f07199ff1d280361edb4dc82c7059957088990a927e08b3545
PAMJA	b2f1702a1b9afb4675474440db500203be6125f275e1ef3aacda82aa5623e118

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	22e31d98aa4d17e6441ed5941629ca2c35ae01a74b5f9ee4b795e4536fc4fbfa
E MËPARSHMJA	0b3e309208cf1bf47cbcd1fd23fa669aa5dd4713cc81b8e1695ff481683bdb87
RRËNJA MERKLE	9def72ec67cc19e19d7afd89aaceb893ee05eec68643756bafa9738daebd45d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/22e31d98aa4d17e6441ed5941629ca2c35ae01a74b5f9ee4b795e4536fc4fbfa>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

27 Shtator 2026, 14:37

"Ishte masë ekstreme", Rama flet nga Rinasi për arrestimin e Vlora Hysenit: Çdo dyshim duhet të hetohet deri në fund

Shkruar nga Newsbomb



Kryeministri Edi Rama është drejtuar nga me një videomesazh nga aeroporti "Nënë Tereza", menjëherë pasi mbërriti nga SHBA, ku ka komentuar zhvillimet e fundit, lidhur me masën e arrestit në shtëpi të ish-drejtuës së SHISH, Vlora Hyseni, duke e cilësuar masën ndaj saj "ekstreme".

Ai theksoi se nuk ka të drejtë të ndërhyjë në përmbajtjen e dosjes apo në arsyet që kanë çuar gjykatën në marrjen e këtij vendimi.

"Sapo jam kthyer nga New York ku siç e dini përfaqësova Shqipërinë në OKB. Vendosa të drejtohem menjëherë nga aeroporti 'Nënë Tereza'. Zhvillimet e fundit, pas vendosjes së masës të arrestit shtëpie për ish-drejtuësën e SHISH, kërkojnë adresim të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë. Ishte pa diskutim një masë ekstreme po të mbajmë parasysh se bëhet fjalë për ekspozimin e një institucioni të veçantë. Unë s'kam të drejtën të ndërhyj në përmbajtjen e dosjes dhe çfarë e ka çuar gjykatën ta bëjë. S'e kam bërë më parë dhe as nuk do ta bëj. Çdo dyshim duhet të hetohet deri në fund. Çdo akuzë duhet të rrëzohet ose të provohet përmes një procesi të paanshëm. Ur puna sjell që hetimi të zgjidhet deri te kreu, nuk është problemi i një shteti të pavarur, por i krejt shtetit. I ka lënë pa fjalë partnerët tanë," tha Rama.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Showbiz & Lifestyle

Dua Lipa në dasmë shqiptare sepse martoi djalin e hallës, videot e kërcimit e postarit botëror bënë xhiron e rrjeteve sociale



Sporti

Fenomeni 4 vjeçar Luan Hasani nga Gjermania në Air Albania, takon idhullin Kristjan Asllani para ndeshjes, ka miliona ndjekës në botë (VIDEO)

Zbulu më shumë artikuj >

Gjithashtu Rama u shpreh se nën titullin e gjyqimit Hysenit janë detyrë e drejtësisë, ndërsa mbrojtja e SHISH nga dëmet që mund të shkaktohen gjatë këtij procesi është përgjegjësi e shtetit.

"Nuk është hera e parë në historinë e botës që shefi i një shërbimi sekret merret i padehurur, por e para që institucioni i shërbimit sekret bëhet target kombëtar dhe ndërkombëtar thashethemesh mediatike për shkak të mosmarrjes së atyre masave që shtetet marrin. Hetimi dhe gjykimi i Vlora Hysenit janë detyrë ekskluzive e drejtësisë. Mbrojtja e SHISH dhe jo vetëm, nga çdo dëm i panevojshëm kolateral, është detyrë e gjithë shtetit. Ndarja e pushteteve nuk mund të shfaqet si ndarje nga mbikëqyrja shtetërore. Ka ardhur koha ta trajtojmë bashkërisht dhe seriozisht. Besoj se Këshilli i Sigurisë i thirrur nesër është vendi i duhur për të reflektuar mbi përgjegjësitë institucionale", tha kryeministri.

Duke iu referuar mediave, Rama u shpreh se Prokuroria dhe gjykatat duhet të kryejnë funksionet e tyre, ndërsa media duhet të informojë publikun, por pa e zëvendësuar procesin gjyqësor. Po ashtu ai tha se i përket Hysenit i ka hapur vetes një llogari me drejtësinë.

"Drejtësia nuk mund ta luftojë paligjshmërinë në oborrin e sipërmarrjes apo krimin pa adresuar paligjshmërinë në oborrin e vet. Pavarësia e drejtësisë smund të shfaqet si shkëputje nga Kushtetuta dhe shpërfillje. Prokuroria ka të drejtën dhe detyrën të hetojë, gjykata të gjykojë, media të zbulojë dhe informojë, por askush s'ka të drejtë ta shpallë tjetrin fajtor dhe ta dehumanizojë. Shteti ligjor ndërtohet me kurajën për të hetuar të fuqishmin dhe sigurinë për të mbrojtur të drejtat e njeriut që heton. Për sa më takon, kur një zyrtar i lartë i ka hapur vetes një llogari me drejtësinë, edhe kjo e ish-drejtueses së SHISH, është një çështje individuale mes saj dhe organeve të drejtësisë. Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar", tha Rama.

Po ashtu, kryeministri foli për pasojat politike të zhvillimeve të fundit, duke kundërshtuar interpretimin se hetimet dhe arrestimet e zyrtarëve të lartë tregojnë se qeverisja e tij është përfshirë nga korrupsioni. Sipas tij, fakti që drejtësia po heton persona me funksione të larta shtetërore tregon se institucionet e drejtësisë po ushtrojnë kompetencat e tyre.

"Nuk kam asnjë gjë tjetër për të shtuar por tani kam ende për të thënë për kuptimin politik të këtij zhvillimi pasi edhe këtë herë u ngrit në kupë të qiellit një aktakuzë kundër qeverisë dhe meje personalisht, me refrenin e shfrenuar 'na mbyti korrupsioni. Pavarësisht bindjeve dhe kahjes së votës, fakti që drejtësia prek edhe njerëz me funksione të larta, anëtarë të qeverisë e bashkëpunëtorë nuk provon se na mbyti korrupsioni apo se po shtohet. Përkundrazi. Faktet se në episodet e këtij kapitulli të ri për Shqipërinë nuk provon asesi që shumica qeverisëse është e korruptuar. Ky fakt, këto episode, kjo drejtësi e re ku kurrë më parë nuk ka pasur një lloj drejtësie të pavarur, ku ska pasur kurrë një udhëheqje politike e interesuar për ti dhënë pavarësi apo forcë politike për ta mbështetur atë duke marrë përsipër kostot, provojnë të kundërtën e avazit që na mbyti korrupsioni. Korrupsioni po goditet nuk po rritet. Shumica e qeverisëse është e palëkundur në luftën kundër korrupsionit mbi të gjitha brenda rradhëve të saj. Jemi të angazhuar deri në fund, qoftë për reforma qoftë për përballimin e kostove politike që sjell angazhimi kundër korrupsioni i organeve të drejtësisë" tha Rama

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





E Diel 15:53

Operacioni shkolla të Pastra/ Kush janë gjithë të arrestuarit e operacionit të djeshëm, zbardhen emrat pas vendosjes në burg nga gjykata (LISTA – EMRAT)



Aktualitet

"Le ta hedhin atë bombë mëngjes, drekë dhe darkë", Rama u përgjigjet kundërshtarëve: Ata katër të vrarët në bulevard nuk kanë marrë akoma drejtësi

E Diel 15:41



Aktualitet

"Kam fajet e mia, por askush s'më bën dot palë", Rama: Nuk kam prekur paratë, pronat dhe interesat e shqiptarëve në 28 vite në qeveri

E Diel 15:24




E Diel 15:03

"Premtova Rilindjen dhe një qeverisje ku askush nuk do të shkelte në dërrasë të kalbur", Rama: Kryeministri nuk mund të parashikojë sjelljen e një individi



Aktualitet

Rama i përgjigjet opozitës për emërimin e Hysenit në krye të SHISH: Ka nisur të punojë pranë meje në rolin e këshilltares, kishte referenca të shkëlqyera nga partnerët



Aktualitet

Rinasi "bashkon" Raman dhe Berishën, njëri me mesazh për shqiptarët, tjetri drejt Strasburgut

E Diel 14:09



E Diel 13:27

Rama mbërrin në Rinas nga Amerika, pritet mesazhi për shqiptarët



Aktualitet

Nesër Konferenca Ndërparlamentare, i pranishëm Rama, Peleshi dhe Schieder! Në fokus të diskutimeve zgjerimi i BE dhe integrimi i Shqipërisë

E Diel 13:04



Aktualitet

Një ish-shpërndarës dhe një ish-pollic, dalin dy emrat e parë të të arrestuarve në operacionin "Shkolla të Pastra"

E Diel 12:50



Aktualitet



E Diel 12:35

Detajet nga tragjedia greke/ Tre shqiptarët që humbën jetën, dy nga Tropoja dhe Erisa nga Elbasani, pritet hetimi për shpërthimin në lagjen Plakë





Aktualitet

Ishin shpallur në kërkim
ndërkombëtar nga Italia dhe Kosova,
arrestohen në Tiranë dy persona!
Akuzohen për drogë dhe falsifikim
kartëmonedhash


🕒 E Diel 12:22



Aktualitet

GJKKO lë në burg Bledar Cagin,
akuzohet për trafik droge dhe grup
të strukturuar kriminal

🕒 E Diel 11:53



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.